



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 244, datë 26.11.2018

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË NJEHËSUAR DHE TË STANDARDIZUAR TË LLOGARIVE PËR TË LIÇENSUARIT NË SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE PËR AKTIVITETET E TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 45 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve lidhur me miratimin e sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të liçensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me Vendimin Nr.166, datë 19.07.2018 vendosi: “Fillimin e procedurave për miratimin e sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të liçensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike.”
- Mbas njoftimit zyrtar dhe publikimit të këtyre dokumentave në faqen zyrtare të ERE-s OSHEE me shkresën Nr.16156/1 Prot., datë 11.09.2018 paraqiti opinionin e shoqërisë lidhur me miratimin e sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të liçensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike.
- Në mbështetje të nenit 13, pika 1 dhe nenit 20, gërma “d”, të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 27 të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, u zhvilluan seanca teknike me shoqëritë për diskutimin e këtyre drafteve përkatesisht në datë 09/10/2018 me OSHEE sha dhe në datë 16.10.2018 me OST.
- Gjate diskutimeve me përfaqesuesit e OSHEE-së nga ana e tyre u paraqit e vështirë detajimi i informacionit kontabël në shkallën që kërkojnë listat rregullatore për arsye të shumta ndër të cilat dhe më kryesoret mund të përmenden:
 - Mungesa e një rregjistri të përditësuar të aktiveve afatgjata i cili të mundësojë klasifikimin e tyre sipas funksionit dhe destinacionit në përputhje me kërkesat e listave të llogarive rregullatore

- Vështirësi që lidhen me organizimin e punës i cili jo gjithmonë i përgjigjet asaj ndarje detyrash që kërkon evidentim të detajuar të zërave të kostove sipas listave të llogarive
- Nga ana e OST nuk pati reagim zyrtar dhe deri me sot mbas një muaji të zhvillimit të sëancës ende nuk ka ndonjë opinion mbi këto lista .

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike (Tabelat bashkëlidhur këtij vendimi
2. Në vlerësim të konstatimeve gjatë shqyrtimit të materialit, shoqërive iu lihet një periudhë tranzitore për paraqitjen e informacionit për vitin 2018 deri në datë 31.03.2019.
3. Drejtoria e Burimeve Njerezore, Administrim Finances dhe Marrëdhënieve me Jashtë të njoftojë të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI